

## RELACION TEKNIK



**OBJEKTI**  
**"KONVIKTI I SHKOLLES HOTELERI TURIZEM" TIRANE**

**POROSITES**  
**DREJTORIA E KONVIKTEVE TE SHKOLLAVE TE MESME, BASHKIA TIRANE**

Hartuan relacionin:

**Ark. Alida Salillari**  
**Lic. 1563/3**

**Ing. Andon Frrokaj**  
**Lic. 1490/1**

## 1.HYRJJE

Ky dokument eshte pjese perberese e dokumentacionit te projektit te zbatimit dhe preventivit perfundimtar per objektin e mesiperm dhe si i tille do te lexohet se bashku me vizatimet teknike dhe detajet e projektit.

Detyrat e ketij raporti jane:

- Te evidentohen problematikat ndertimore ne objekt
- Te shpjegohet qasja per zgjidhjen e ketyre problematikave
- Te shpjegohet zgjidhja me fjale

### **Qellimi**

Qellimi i ketij projekti eshte propozimi i nderhyrjeve ndertimore ne objektin ekzistues ne fasaden e tij, ndertimi i shkalleve te emergjences si dhe hidroizolimi i taracave, perdorimi i materialeve bashkekohore qe bejne hidroizolimin dhe termoizolimin e nderteses te cilat sjellin uljen e konsumit te energjise elektrike si dhe rritjen cilesise se banimit per nxenesit konviktore per nje jetese komforte.

### **Objektivat**

- ✧ Ndertimi i shkalleve te emergjences me konstruksion metalik
- ✧ Riparimi suvatimeve te demtuara, realizimi i suvase se re per siperfaqet e amortizuara ne fasade
- ✧ Realizimi i sistemit kapote ne fasade
- ✧ Hidroizolimi i taraces
- ✧ Largimi i ujrave te taraces nepermjet zevendesimit te ulluqeve horizontale e vertikale ekzistuese PVC me materiale bashkekohore si dhe sistemimi dhe ndertimi i trotuarit perreth objektit ne segmentet qe mungon
- ✧ Lyerja me boje e ambienteve te brendshme e te jashtme

## **Gjendja ekzistuese**

**Pershkrimi:** Kjo godine eshte ndertuar ne para viteve '90 dhe megjithese jane kryer riparime te pjesshme ne vitet e fundit, aktualisht vihen re probleme ne hidroizolimin e taraces te cilat kerkojne nderhyrje sa me te shpejte per te shmangur perparimin e tyre. Objekti eshte 4 katesh me konstrukcion mure mbajtese e themele te vazhduara, me mbulesa tarace. Vitet e fundit eshte realizuar nje shtese 3 kateshe ne anen veriore me konstrukcion b/arme.

**Kapaciteti:** Ne kete godine banojne rreth 100 nxenes konviktores. Gjithashtu ne mjediset e saj gjenden zyra e ambiente sherbimi per administraten e Drejtorise se Konvikteve.

**Vleresimi fizik i objektit:** Objekti eshte relativisht i mirembajtur dhe si rezultat i nderhyrjeve te here pas hershme te rikonstrukcionit. Nderhyrje jane realizuar kryesisht ne rikonstrukcionin e nyjeve sanitare, ne zevendesimin e dyerve dhe dritareve, ne riparimin e rretit elektrik etj. Megjithate, nga kqyrja ne vend, rezulton qe ka disa probleme te cilat kerkojne nderhyrje imediate ne menyre qe te mos rendohen me teper sic eshte nderhyrja ne hidroizolimin e taraces se objektit. Mbulesa e objektit eshte realizuar tarace me solete b/arme e hidroizoluar me katrama + lluster cemento. Nga kqyrja ne vend rezulton se ne tavanin e katit te trete ka njolla lageshtie te shkaktuara nga rrjedhja e ujerave te shiut pasi ulluqet dhe tubat e shkarkimit jane te amortizuar dhe jashte funksionit. Hidroizolimi ekzistuese i taraces eshte i amortizuar nuk ploteson asnje kusht per largimin e ujrave.

## **Pershkrimi i projektit**

Punimet e parashikuara per t'u realizuar jane si me poshte:

- Rehabilitimi i fasades se objektit. Per te permiresuar anen estetike te objektit si dhe per rritjen e eficenses se energjise do te perdoret sistemi kapote per fasaden (termoizolimin). Rehabilitimi i fasades duhet te behet i plote, duke bere riparimin e suvatimit, shpatullimin e dritareve me suva grafiato dhe polisterol t=3cm, riparimin e parapetit te taraces e realizimin me suva grafiato te saj si dhe vendosjen e davancialeve te dritareve me mermer t=2 cm ne pjesen e jashtme i njejte me mermerin ekzistues.
- Prishja e hidroizolimit ekzistues dhe realizimi i hidroizolimit te ri me 2 duar dhe shtrese mbrojtese lluster cemento.

- Ndertimi i rrjetit te ri te shkarkimit te ujerave te taraces nepermjet tubacioneve te llamarines me diameter 100 mm ne cdo pike shkarkimi te Ujerave te taraces do te vendoset kasete shkarkimi.
- Punimet e bojatisjes se ambjenteve te brendshme me boje hidroplastike per perdorime te brendshme te cilesise se pare.
- Ndertimi i shkalles se emergjences eshte parashikuar te realizohet ne fasaden veriore me dalje ne koridorin e brendshem.

### **Nderhyrjet ne eksterier**

Ne te gjithë fasaden do te behet riparimi i suvatimeve te demtuara nga lageshtira, riparimi i davancialeve te dritareve, vendosje e davancialeve te mermerit.

Riparimet e suvatimeve do te behen me llac te gatshem.

Llaçi i gatshëm të jetë i prodhuar për aplikim si material mbushës për mure tulle ose blloqe betoni, për ambiente të brendshme ose të jashtme, dhe të jetë i përgatitur në formë pluhuri me bazë çimento, gëlqere, rërë guri, rezina sintetike dhe aditiv. Duhet të ketë cilësinë që të aplikohet kur temperatura e ambientit të jetë jo më pak se +5°C - +35°C.

Karakteristikat teknike:

- Peshë specifike:  $2 \pm 0.2$  kg/litër
- Raporti i përzierjes: 2-3 litra ujë për 10 kg produkt të thatë
- Rezistenca në përkulje  $\geq 1.5$  MPa (N/mm<sup>2</sup>)
- Rezistenca në ngjeshje  $\geq 4.5$  MPa (N/mm<sup>2</sup>)
- Forca në ngjitje  $\geq 0.8$  MPa (N/mm<sup>2</sup>)

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Standartin Shqiptar SSH EN 998-1:2016 ose ekuivalentin e tij. Ky standart është i zbatueshëm për llaçet e fabrikuara të suvatimit dhe stukimit, të bëra në bazë të lidhjeve inorganike për përdorim të jashtëm (prodhues) dhe të brendshëm (suvatim) në mure, tavane, kolona dhe ndarëse. Ai përmban përkufizime dhe kërkesa përfundimtare të performancës së produktit.

Veshja e fasades do te behet me polisterol me trashesi 5 cm me peshe 15 kg/m<sup>3</sup> i montuar ne fasade me upa + rrjet + 2 duar kolle + astar + grafiato 1 mm.

Lyerja me boje akreliko ne siperfaqen qe do te nderhyhet ne fasade.

- Materiali për lyerjen e fasadës është akrilike me ngjyrë, për lyerje të jashtme. Boja për fasada duhet të jetë e prodhuar për përdorim të jashtëm me rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë. Boja do të ofrohet sipas ngjyrave të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Të jetë e përshtatshme për sipërfaqe të re apo të vjetër si suva, e stukuar, e lyer etj. dhe të ketë shkallë të lartë mbulimi.

#### Karakteristikat Teknike:

- Natyra e lidhësit: Kopolimer (rezinë) akriliku
- Viskoziteti:  $110 \pm 20$  KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
- Tharja:  $\leq 5$  orë
- Norma e hapjes:  $\geq 18$  m<sup>2</sup>/litër (me një shtresë trashësi filmi 80-100µm)
- Peshë specifike:  $1.5 \pm 0.2$  kg/litër
- Hollimi: 10-15 % me ujë
- Pamja estetike: E lëmuar, mat, pa shkëlqim

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (përbërësit organikë të paqëndrueshëm):  $\leq 40$  g/l.
- Standartin Shqiptar SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalentin e tij për bojra dhe llaqe, lidhur me rezistencën në fërkim të lagësht dhe aftësia për t'u pastruar e veshjeve/shtresave të holla të lyerjes, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.
- Standartin Shqiptar SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalentin e tij, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.

## **SHKALLËT E EMERGJENCËS**

### **Përshkrimi i përgjithshëm**

Në krah të godinës ekzistuese, ne fasaden veriore të saj, do të ndërtohet shkalla e emergjencës metalike që do të shërbejë si shkallë në rast zjarri apo daljes së shpejtë nga godina. Sistemi strukturor për të cilin është llogaritur dhe projektuar është sistem sistem ramë tredimensional hapësinor metalik. Elementët kryesorë mbajtës janë themelet b/a, kollonat dhe trarët metalikë. Struktura është e ndarë me fugë sizmike me strukturën ekzistuese të shkollës. Struktura ngrihet 4kate mbi tokë dhe mbulimi saj bëhet me panele sandwich. Hyrja në shkallët e emergjencës do të

behet nepermjet deres se emergjences ne koridoret e cdo kati te objektit. Per te realizuar vendosjen e deres se emergjences do te prishen muret ne koridoret e cdo kati me gjeresi 100 cm e lartesi 230 cm.

### **Llogaritjet Strukturore**

Struktura është llogaritur në programin SAP2.

Elementët kryesorë strukturorë kanë dimensionet e mëposhtme (shih vizatimet për më shumë informacione në lidhje me detajet)

Të gjithë elementët strukturorë (kolonat, trarët, soletat dhe themelet) e strukturës janë projektuar në përputhje më Eurocode dhe plotësojnë të gjitha pikat e mëposhtme:

- *Analiza globale e seksionit (në përputhje me EC3)*
- *Projektimi i seksionit tërthorë (në përputhje me EC3)*
- *Verifikimi i humbjes së qëndrueshmërisë së pllakave metalike (në përputhje me EC3)*
- *Kontrulli i uljeve (në përputhje me EC3)*

### **HIDROIZOLIMI I TARACES**

Hidroizolimi i taraces do te realizohet per te gjithë siperfaqen e godines. Per kete arsye eshte e nevojshme riberja e shtresave te h/izolimit si dhe disa punime riparimi per permiresimin dhe optimimin e kushteve te nderteses dhe te kullimit te ujerave te shiut si dhe per te perdorur materiale e teknika qe perdoren aktualisht ne ndertim. Nderkohe i gjithë parapet i taraces do te vishet me kornize llamarine xingat.

Taraca e objektit eshte e pa shfrytezueshme, tarace e cila nuk lejon trafik kembesoresh me frekuence te larte. Pas prishjes se shtresave te hidroizolimit ekzistues do te behet pastrimi mga pluhurat e pa pastertite ne te gjithë siperfaqen e taraces.

Aplikimi i shtreses hidroizoluese do te behet si me poshte:

- ✓ Mbi shtresen e llustres cimentos (termoizolimit) aplikohet lyerja me 2 duar bitum
- ✓ Membrane bituminoze 1 me trashesi 4 mm ngjitja aplikohet me flake.
- ✓ Membrane bituminoze 2 me trashesi 4 mm ngjitja aplikohet me flake.
- ✓ Shtrese mbrojtese lluster cemento 3 cm.

Perveç punimeve te hidroizolimit ne tarace eshte menduar te kryhen disa punimete tjera per te realizuar kullimin e plote te ujerave si punime per ulluqet e shkarkimit, kasetat e shkarkimit, veshjet

me llamarine xingato te strehave dhe parapetit, punime ne suvatimet e parapetit dhe riparime te oxhaqeve duke i rrethuar me mur me tulla te plota zak.

Propozimi per punimet qe do te kryhen ne tarace.

Prishje e shtresave hidroizoluese

Heqje e tubave shkarkimit, veshjes e strehes me llamarine

Punime per shtresat e hidroizolimit

Riparimi i muratures se oxhakut

Punime impluve llamarine

Punime ulluqe vertikale llamarine xingato

Materialet e perdorura ne hidroizolimin e taraces do te plotesojne KTP dhe STASH ne fuqi.

## **PUNIMET E BOJATISJES**

Siperfaqet e brendshme mure e tavane do te lyhen me boje plastike.

Boja plastike do të jetë cilësore, pa erë që nuk ndikon në përhapjen e zjarrit, e tille qe të përdoret për ambiente të brendshme. Përbëja e saj do të jetë me bazë vinilike (PVA polimer) dhe në shpërndarje ujore i jep asaj rezistence optimale ndaj agjenteve të jashtëm. Formula e saj nuk duhet të dëmtojë përdoruesin dhe do të jetë e përshtatshme për t'u aplikuar mbi suva, tullë, gips, beton etj. Duhet të ketë aftësi të mira mbuluese.

Karakteristikat teknike:

- Natyra e lidhësit: Kopolimer (PVA polimer) vinilike
- Viskoziteti:  $100 \pm 20$  KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
- Tharja:  $\leq 5$  orë
- Norma e hapjes:  $\geq 18$  m<sup>2</sup>/litër (me një shtresë trashësi filmi 80-100µm)
- Peshë specifike:  $1.5 \pm 0.2$  kg/litër
- Hollimi: 10-15% me ujë
- Pamja estetike: E lëmuar, mat, pa shkëlqim

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm):  $\leq 30$ g/l.
- Standartin Shqiptar SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalentin e tij për bojra dhe llaqe, lidhur me

rezistencën në fërkim të lagësht dhe aftësia për t'u pastruar e veshjeve/shtresave të holla të lyerjes, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të.

- Standartin Shqiptar SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalentin e tij, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.

**Hartuan relacionin:**

**Ark. Alida Salillari**  
**Lic. 1563/3**

**Ing. Andon Frrokaj**  
**Lic. 1490/1**